



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2016

**Drejtuar: MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT**

TIRANË

Lënda: Monitorim vlerësimi i treguesve buxhetor për vitin 2015

Në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.160, datë 27.11.2014, “Per buxhetin e vitit 2015”, me ndryshimet përkatëse, Udhëzimit Nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit Plotësues Nr. 2, datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, paraqesim informacion mbi realizimin e fondeve buxhetore, efektivitetin e përdorimit të tyre dhe performancën e produkteve të realizuara me këto fonde, për vitin 2015, për sistemin e MZHETTS-së.

Mbështetur në Aktin Normativ Nr. 1, datë 29.07.2015 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, me rishikimin e buxhetit për vitin 2015, në sistemin e MZHETS transferohet Programi “Zhvillimi i Turizmit”, ku përfshihen 3 Institucione buxhetore: Agjencia Kombëtare e Turizmit, Zyrat e Shërbimit Turistik dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit.

Njësitë strukturore të përfshira në këtë program, kishin kaluar në varësi administrative të MZHETS, në zbatim të VKM Nr. 226, datë 25.02.2015 “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve dhe fondeve buxhetore, për vitin 2015”.

Si rezultat MZHETTS, i menaxhon fondet buxhetore në 4 programe, që përfshijnë 12 institucione buxhetore:

1. Planifikim Menaxhim Administrim
2. Mbështetje për Zhvillim Ekonomik
3. Mbështetje për Mbikqyrjen e Tregut, Infrastruktura e Cilesisë dhe Pronën
4. Mbështetje për Zhvillimin e Turizmit

Në total fondet buxhetore, per vitin 2015, kane qenë 1,589,700 mijë lekë, të cilat sipas strukturës buxhetore paraqiten sipas tabelës së mëposhtme :

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani 2015	Plan i rishikuar 2015	Realizimi 2015	Realizim ne %
Paga dhe Sigurimet	444,000	459,101	456,867	99 %
Shpenzime të tjera korrente	305,400	521,851	463,358	89%
Investime të brendshme	235,000	228,879	211,867	97%
Financime të huaja	1,000,000	379.869	345,974	91%
TOTALI MZHETTS	1,984,400	1,589,700	1,478,065	93%

Më poshtë analizojmë shpenzimet sipas natyrës dhe faktorët që kanë ndikuar:

Shpenzimet e Personelit. Fondet e realizuara për personelin këte vit kanë rezultuar 23% më shumë se viti 2014, për shkak të zgjerimit të aktivitetit dhe fushës së përgjegjësisë, me përfshirjen edhe të funksionit të zhvillimit të turizmit. Realizimi në ate mase ka ardhur për shkak të mosplotësimit të numrit të punonjësve, sipas strukturave të miratuara. Rishikimi i strukturës dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzor, përmes trajnimeve sipas standardeve i është përgjigjur prioriteve dhe objektivave në përputhje me programin .

❖ **Shpenzimet e tjera korrente,** janë realizuar rreth 89 % si rezultat:

- Shpenzimet operative të konsideruar si shpenzime bazë të funksionimit të veprimtarisë së ministrisë kanë qënë të qëndrueshme dhe nuk kanë ndryshime në strukturë shpërndarje, me vitin e kaluar. Realizimi i shpenzimeve në këtë kategori është bërë sipas regjistrit të parashikimit publik, me ndryshime të reflektuara edhe gjate vitit, në varësi të nevojave të institucionit.
 - Kufizimi e një pjesë të shpenzimeve të këtij grupimi, ka ndikuar zhvendosja në ambjentet e reja të punës (Shtëpia e Ushtrakeve), për 3(tre) institucione QKR, QKL dhe DPPM. Grupimi kryesor i shpenzimeve operative: Shërbime nga të tretë, energji, uje, telefon, është është realizuar me korrektesi.
 - Transfertat korrente me jashtë janë realizuar totalisht për fatura të paraqitura, nga organizmat ndërkombëtar, ndaj të cilëve MZHETTS ka detyrime.
 - Lidhur me Transfertat korrente me brënda, në kuadër të parandalimit dhe shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, nga fondi i çelur në shumën 62,7 mln lekë per Aparatin, u transferuan vetëm 22,4 mln lekë, në llogarinë e subjektit Qendra Kombëtare e Panairëve, që përfaqëson kthimin e qirave të paguara nga Shoqëria “Top Channel” dhe të derdhura në buxhet. Pjesa tjetër e fondit te akorduar është kthyer buxhetit.

❖ **Investimeve të brendshme,** rezulton se shpenzimet për investime janë realizuar rreth 97 %

I. Në Programin “**Planifikim Menaxhim Administrim**”

- Janë rikonstruktuar ambjentet e Ministrisë, duke siguruar kushte me të mira pune dhe komoditet të nevojshëm, per punonjesit e Aparatit te Ministrisë.
- U siguria Rregjistri i monitorimit të Investimeve publike, nëpërmjet implementimit të Platformes RMIP, duke siguruar saktësinë e informacionit, perditësimin dhe monitorimin e investimeve publike hap pas hapi. Kjo beri te munder lehtesimin per krahasueshmerine e te dhenave, saktësinë e tyre per nje analize korrekte dhe transparencen ne informacion, e cila ndikoi ne marrjen e masave per uljen e riskut dhe realizimin me te mire te tyre, gjate zbatimit .
- U realizua projekti i pajisjeve auto vizuale ne vlere 5,9 mln leke, duke sjelle nje impakt pozitiv ne sigurine dhe mbarevajtjen e sherbimit
- Për Aparatin janë kryer pagesa, për detyrimin TVSH në vlerën 2 mln lekë, nga 3.1 mln leke e planifikuar për projektin “Mbështetje për harmonizimin e të drejtës ekonomike dhe tregtare me normat e BE”, kjo për shkak të mosdërgimit të plotë të faturave përkatëse.

II. Në Programin Mbështetje për Zhvillim Ekonomik, i cili zë peshën me të madhe në Ministri, për nga madhesi e fondeve buxhetore, 45 % e fondeve të planifikuar i zë ky program dhe përgjegjësia për të realizuar qëllimin dhe objektivat e Politikës së tij, është vlerësuar nga institucionet pjesëmarrëse, si njësi zbatuese, për t i shërbyer krijimit të një

klime pozitive, për zhvillimin e biznesit, krijimit të vendeve të reja të punës, reduktimit të informalitetit dhe krijimit të një mjedisi konkurrues për zhvillimin e investimeve

- ✓ **Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve**, në përputhje me objektivat arriti të realizojë projektet e investimeve 86%, duke i promovuar këto fonde dhe ndërgjegjësuat biznesin, për mënyrën e aplikimit të tyre dhe përfitueshmërinë.
 - Fondi i Konkurrueshmërisë, i realizuar në shumën 20,830,824 lekë. Kanë aplikuar 60 kompani dhe miratuar 29 prej tyre. Realizimi i këtij projekti përkthehet në mbështetje dhe zhvillim të SME, zhvillim në sektorin e eksporteve, përmirësim në cilësinë e produkteve të eksportuara si dhe rritja në konkurrueshmërinë e tyre në treg.
 - Projekti “Mbeshtetje e biznesit kreativ” realizuar në shumën 4,854,023 lekë. Kanë aplikuar dhe janë miratuar 9 artizane, duke u përkthyer kjo në sukses të qëllimit të këtij projekti për rritjen e aktiviteteve ekonomike të qëndrueshme dhe krijimin e vendeve të punës kryesisht në sektorin e artizanatit. Impakti është kryesisht i adresuar në këto elementë: Zhvillimin e produktit, marketingun, kualifikimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të sektorit të artizanatit.
 - Projekti “Biznese të mbështetura në fondin start-up” realizuar në vlerën 2,653,700 lekë janë mbështetur disa biznese që drejtohen nga femra apo që janë në fazën fillestare të tyre (start-up). Kjo përkthehet në realizim të vazhdueshëm të objektivit primar për *Zhvillimin e SME-ve dhe sipërmarrjes*, me rritjen çdo vit të numrit të ndërmarrjeve të reja dhe atyre inovative dhe nëpërmjet një financimi më të mirë, duke përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme klimën e biznesit, në nxitjen e shpirtit të sipërmarrjes.
 - Projekti “Edhe unë kam një ëndërr” realizuar në vlerën 3,894,930 lekë, duke financuar projektet fituese të konkursit me të njëjtin emër. Ky fond ka pasur impakt pozitiv pasi 12 projekt-identet fituese me finalizimin e tyre do të japin kontribut në zhvillimin e mëtejshëm të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Nëpërmjet këtij fondi AIDA i ka dhënë mbështetje individëve për të iniciuar krijimin e një biznesi start – up nëpërmjet idesë së tyre dhe 2 personave fizik për të zhvilluar biznesin e tyre me projekt idenë fituese.
 - Ndërsa për Projektin “Expo Milano 2015”, realizimi i fondit në zbatim të VKM Nr.140/2014 mbi miratimin e “Pjesëmarrja e Republikës së Shqipërisë në Panairin Expo Milano 2015”, është realizuar në vlerën 52,464,205 leke, në masën 99%. Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë aktivitet ka stimuluar ndjeshëm investimet italiane në vend. Tematika me të cilën është prezantuar vendi ynë ka qenë “Our Food, Our Story”, dhe impaktin në : Konsolidimi i imazhit të Shqipërisë dhe pozicionimit të saj, Promovimi i Shqipërisë si destinacion i interesave të ndryshëm dhe zhvillimi i partneriteteve të mundshme në kuadër të projekteve të investimeve.
- ✓ **Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit** projektet e investimeve janë realizuar në masën 98 % kryesisht :
 - Projekti “Përmirësimi i sistemit, krijimi i moduleve të reja dhe i raportimeve; Shtimi i dy shërbimeve të reja (për sistemin e brendshëm online, aplikimi për regjistrim të vendimeve / akteve të gjykatës, Zyres përmbartimore ose të autoriteteve të tjera publike; Blerje e sistemit të numerimit për sportelet e QKR-së” realizuar në total në vlerën 16.3 mln. Realizimi i këtij projekti ka sjellë ndërtimin e një sistemi në përputhje me standardet dhe praktikën me të mira të regjistrimit të biznesit duke shndërruar QKR si sportel me një ndalesë ku kryhen të gjitha regjistrimet e biznesit duke sjellë shmangjen e rradhëve të gjata, ndarjen e proceseve të punës nëpër sportele të cilat në periudha të ndryshme e kalojnë fluksin e parashikuar. Është arritur të plotësohet regjistri tregtar në formë elektronike me të gjitha të dhënat e transferuara nga regjistrat tregtar të gjykatave. Kjo përkthehet në zhvillim të qëndrueshëm të biznesit nëpërmjet përmirësimit të klimes së tij. Përmirësim të infrastrukturës dhe plotësimi i nevojave të institucionit.

III. Në Programin **Mbështetje për Mbikqyrjen e Tregut, Infrastruktura e Cilesisë e Pronësi Industriale**”.

Jane realizuar objektivat e identifikuar në politikën e tij, nëpërmjet mbështetjes dhe promovimit të përdorimit të standardeve europiane e ndërkombetare, mbështetjes së pronësisë industriale, dhe zhvillimit të tregtisë dhe konkurrencës së ndershme si vijon :

- Janë realizuar objektivat lidhur me adoptimin e standardeve shqiptare, duke promovuar përdorimin e atyre Europiane. Ka rritje të shitjes së Standardeve.

- Jane realizuar objektivat lidhur me mbrojtjen e markave, patentave dhe regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, nëpërmjet vlerësimit të aplikimeve, kërkesave për regjistrim për shpikje të depozituar, aplikimeve për ripërtëritje dhe ndryshimeve të kërkuar për marka dhe patenta.

✓ **Për Drejtorinë e Përgjithëshme të Metrologjisë**, Projektet e realizuar në masën 100% kryesisht:

- Projekti “Blerje paisje për laboratorin e volumeve, rrjedhjeve dhe kimise” realizuar në vlerën 22 826 000 leke pra 100%. Realizimi I këtij projekti perben sukses pasi per here te pare ne Shqiperi do te behet:

- Kalibrimi i instrumentave mates te PH dhe Konduktivitetit, që përdoret nga laboratorët e fushave të ndryshme (si laboratorët: e mjeksisë, mjedisit, analitik-laboratorë që bëjnë analiza kimike).

-Nepërmjet këtij investimi jane blere paisje te sistemit për matjen e PH, dhe sistemit për matjen e Konduktivitetit (material referuese të çertifikuara dhe instrumenta etalone). Kjo përkthehet në një treg me standarde të certifikuar.

- Janë kryer nga Drejtoria e Përgjithëshme e Metrologjisë, inspektimet e parashikuara në subjekte, për përdorimin e instrumentave matës dhe verifikimi i matësve në përdorim .

-Janë realizuar kalibrimet në fushën e masës, forcës, volumit, gjatësisë dhe ato në fushën elektrike.

IV. Lidhur me Programin **“Mbështetje për Zhvillimin e Turizmit”**, Institucionet që përfshihen në të janë angazhuar në realizimin e objektivave, brënda fushës së përgjegjësisë shtetërore, kryesisht:

-Pastrimin, monitorimin dhe mbikqyrjen e Zonës Bregdetare, në sezonin veror, nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Hapjen për herë të parë për vizitorët të Ishullit të Sazanit në përputhje me planin e vendosur për menaxhimin e tij, ku u angazhuan 300 punonjësit me kontrate të përkohshme pune, miratuar me VKM Nr.379, datë 7.05.2015, për periudhën 15 maj -15 Shtator 2015.

- Organizimi i veprimtarive turistike nga Agjencia Kombetare e Turizmit, nëpërmjet panairëve, ekspozitave , materialeve promovionale dhe dokumentare, për promovimin dhe zhvillimin e Turizmit dhe Shqipërisë si “destinacion turistik” në Europë e më gjerë.

Te shtohet aktiviteti i AKT, për vitin 2015

❖ **Lidhur me Financimin e Huaj**, janë realizuar në masën 91 %, për sa më poshtë :

- *Projekti “Programi Italo-Shqiptar për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri nëpërmjet një linje kredie për SME-të dhe sigurimin e Asistencës Teknike për to’*, si nisme me financim të Qeverisë Italiane “Mbështetje për SME-t”, nëpërmjet kreditimit me kushte lehtësuese të bizneseve, në zërin Investime kapitale të huaja.

Prej fillimit të Programit janë lëvruar hua në dobi të 107 SME-ve Shqiptare me një pagesë të përgjithshme prej 23.6 milion Euro, mbështetur në Linjën e Kredise prej 25 milion Euro. Për periudhën Janar-Dhjetor 2015 janë disbursuar gjithsej në total 11 projekte me vlerë 2,276,964 Euro.

Kjo nismë është konsideruar si një rast sukcesi, sidomos duke patur parasysh mundësinë e sipërmarrjeve përfituese të përftonin kredi për investime prodhuese, nga ana e bankave tregtare private pjesëmarrës,. Kompanitë e financuara operojnë në sektorët e prodhimit, agroperpunimit, ndërtimit, përpunimit të drurit, këpucëve, teknologjisë së informacionit etj.

-Projekti “Mbrojtja e markave për produktet ndërkufitare” - është realizuar 100%. Ky projekt ka përfunduar në 1 dhjetor 2015, duke sjelle rritjen e ndërgjegjesimit të SME , publikimit dhe faktoreve të tjerë të përfshirë në sistemin e mbrojtjes së pronësive industriale në Zonat Korce dhe Diber .

Në listën e projekteve me financim të huaj janë përfshirë edhe 3 projekte të përfunduara, por në proces të mbylljes së llogarive bankare në Bankën e Nivelit të Dytë, me qëllim heqjen e tyre nga statusi aktiv, referuar tabelës bashkëlidhur :

- **Projekti “Start W”**
- **Projekti “Promocion për SME”**,
- **Projekti “Western Balkan Countries –INCO.NETENHANCED**

Më konkretisht po paraqesim realizimin e treguesve buxhetore, sipas strukturës, për secilin program.

1. Program “ Planifikim Menaxhim Administrim”

në 000/ lekë

Struktura buxhetore	Plani 2015	Plani i rishikuar 2015	Realizimi 2015	Realizimi në %
Paga dhe Sigurimet	155,800	125,729	125,650	100%
Shpenzime të tjera korrente	128,881	210,397	168,483	80%
Investime të brendshme	54,358	39,653	38,492	97%
Financime të huaja	90,000	19,869	12,125	61%
TOTALI	429,039	395,648	344,751	87%

2. Program “ Mbështetje për Zhvillim Ekonomik ”

në 000/ lekë

Struktura buxhetore	Plani 2015	Plani i rishikuar 2015	Realizimi 2015	Realizimi në %
Paga dhe Sigurimet	112,300	107,336	106,666	99%
Shpenzime të tjera korrente	139,750	135,699	123,454	91 %
Investime të brendshme	159,356	128,108	113,191	88 %
Financime të huaja	650,000	350,000	319,671	91%
TOTALI	1,061,356	721,143	662,982	92%

3. Program “Mbështetje për Mbikqyrjen e Tregut, Infrastrukturen e Cilesisë e Pronësi Industriale ”

në 000/ lekë

Struktura buxhetore	Plani 2015	Plani Rishikuar 2015	Realizimi 2015	Realizimi në %
Paga dhe Sigurimet		144,992	144,990	100%
Shpenzime të tjera korrente		81,235	79,225	97.5%
Investime të brendshme		49,182	48,251	98%
Financime të huaja		10,000	14,177	142%
TOTALI		285,409	286,644	100%

4. Programi “Mbështetje për Zhvillimin e Turizmit ”

në 000/ lekë

Struktura buxhetore	Plani 2015	Plani i rishikuar 2015	Realizimi 2015	Realizimi në %
Paga dhe Sigurimet	0	81,044	79,560	98 %
Shpenzime të tjera korrente	0	94,520	92,196	98 %
Investime të brendshme	0	11,936	11,932	100 %
Financime të huaja				
TOTALI	0	187,500	183,689	98%

Në kuadër të menaxhimit me efektivitet të Aktiveve në pronësi dhe përdorim të njësive të sistemit të MZHETTS, janë ndjekur procedurat standarde lidhur me dokumentimin, (regjistrin e tyre), ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi.

Eshtë ndjekur dhe monitoruar parandalimi dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura financiare, në kuadër të VKM nr.50, datë 05.02.2014, “ Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e planit të veprimit”, për të moskrijuar detyrime të reja dhe marrjen e masave të duhura për kryerjen e pagesave, duke respektuar afatet, dhe monitorimin e tyre të vazhdueshëm.

Duke falenderuar për bashkëpunimin.

FREDERIK SEITI

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Konceptoi: Vali Murashi, Specialiste Buxheti

Konfirmoi: Suzana Stefa, Drejtore Financës